



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 850 /25 Datë: 10.07.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 139 të mbajtur më 30.06.2025, mori:

V E N D I M

I. Riakreditohen programet e studimit në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Arteve për periudhën pesë (5) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2030):

1. Artet Vizuale, BA; (6 specializime), BA, 240 ECTS (R); me kuotë **100** studentë për vit akademik.

1. *Pikturë;*
2. *Skulpturë;*
3. *Grafikë;*
4. *Ilustrim dhe Vizatim;*
5. *Art Konceptual dhe Media të reja;*
6. *Dizajn Grafik dhe Multimedia;*

2. Artet Vizuale, MA (6 specializime), MA, 60 ECTS (R); me kuotë **100** studentë për vit akademik.

1. *Pikturë;*
2. *Skulpturë;*
3. *Grafikë;*
4. *Ilustrim dhe Vizatim;*
5. *Art Konceptual dhe Media të Reja;*
6. *Dizajn Grafik dhe Multimedia;*

II. Riakreditohen programet e studimit në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Arteve për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2028):

3. Master i Muzikës në Performim (5 specializime), MMus, 60 ECTS (R); me kuotë **25** studentë për vit akademik.
 - *Piano;*
 - *Dirigjim;*
 - *Solo këndim;*
 - *Instrumente me harqe dhe tela;*
 - *Instrumentet frymore;*
4. Master i Muzikës në Kompozim (*me specializim në Kompozim*) MMus, 120 ECTS (R); me kuotë **4** studentë për vit akademik.
5. Bachelor i Muzikës (*me specializim në Kompozim*), BMus, 240 ECTS (R); me kuotë **25** studentë për vit akademik.

III. Numri i studentëve aplikohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.

IV. Obligohet Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Arteve që deri më datë 30.09.2025 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.

V. Obligohet Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Arteve të raportojë dhe arsyetojë në AKA çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.

VI. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Arteve brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për ri/akreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Artet Vizuale, BA; (6 specializime), BA, 240 ECTS (R);</i> 1. <i>Pikturë;</i> 2. <i>Skulpturë;</i> 3. <i>Grafikë;</i> 4. <i>Ilustrim dhe Vizatim;</i> 5. <i>Art Konceptual dhe Media të reja;</i> 6. <i>Dizajn Grafik dhe Multimedia;</i>	Bardhyl Bejtullahu Genc Reznqi Mehmet Behluli Mjellma Goranci Rrezeart Galica Sabri Shaqiri Taulant Qerkini Valdeta Vuçitërna Xhevdet Pantina Vlora Ismaili
2.	<i>Artet Vizuale, MA (6 specializime), MA, 60 ECTS (R);</i> 1. <i>Pikturë;</i> 2. <i>Skulpturë;</i> 3. <i>Grafikë;</i> 4. <i>Ilustrim dhe Vizatim;</i> 5. <i>Art Konceptual dhe Media të Reja;</i> 6. <i>Dizajn Grafik dhe Multimedia;</i>	Agron Bytyçi Guri Cavdarbasha Majlinda Kelmendi Mirsad Lushtaku Suad Rama Rudina Xhaferi Yllka Fetahaj
3.	<i>Master i Muzikës në Performim (5 specializime), MMus, 60 ECTS (R);</i> • <i>Piano;</i> • <i>Dirigjim;</i> • <i>Solo këndim;</i> • <i>Instrumente me harqe dhe tela;</i> • <i>Instrumentet frymore;</i>	Besa Llugiqi Lule Elezi Alma Bektashi Arianit Shehu Blerim Grubi Shkumbin Bajraktari Trimor Dhomi
4.	<i>Master i Muzikës në Kompozim (me specializim në Kompozim), MMus, 120 ECTS (R);</i>	Valton Beqiri Dafina Zeqiri Nushi
5.	<i>Bachelor i Muzikës (me specializim në Kompozim), BMus, 240 ECTS (R);</i>	Florita Raifi Misbah Kaçamaku Nezahate Shala Kreshnik Aličkaj Drinor Zymberi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Arteve.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit; *Artet Vizuale, BA; (6 specializime), BA, 240 ECTS (R)*; vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 21.05.2025.

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht të gjitha shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit.

2. Për programin e studimit; *Artet Vizuale, MA (6 specializime), MA, 60 ECTS (R)*; vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 21.05.2025.

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht të gjitha shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit.

3. Për programin e studimit; *Master i Muzikës në Performim (5 specializime), MMus, 60 ECTS (R)*; vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 12.06.2025.

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit;

4. Për programin e studimit; *Master i Muzikës në Kompozim (me specializim në Kompozim), MMus, 120 ECTS (R)*; vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 12.06.2025.

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit;

5. Për programin e studimit; *Bachelor i Muzikës (me specializim në Kompozim), BMus, 240 ECTS (R)*; vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 12.06.2025. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se nga shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht katër (4) fusha të standardeve të akreditimit;

Meqenëse për programet:

3. Master i Muzikës në Performim (5 specializime), MMus, 60 ECTS (R);
4. Master i Muzikës në Kompozim (me specializim në Kompozim) MMus, 120 ECTS (R);
5. Bachelor i Muzikës (me specializim në Kompozim), BMus, 240 ECTS (R);

... nuk ishin vlerësuar plotësisht shumica e standardeve (3 Plotësisht dhe 4 Substancialisht), KShC ka vendosur që riakreditimi të bëhet për periudhën tre (3) vjeçare.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 139-të, të mbajtur më datë 30.06.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Arteve dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Arteve;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Hazi



Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë